

Data: 23.10.2025

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “IMPLEMENTIMI I SISTEMIT TË RREGULLIMIT AUTOMATIK PËR NJËSITË E REJA GJENERUESE PV/WIND, NËPËRMJET CMS HEC VAU I DEJËS DHE IMPLEMENTIMI AUTOMATIK 15 MIN” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 94,551,000 (Nëntëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH ose 978,586 (Nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 23/10/2025 është 96.62 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: *“Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat dhe shërbimet e ofruara në këtë procedurë prokurimi. (Autorizimi duhet të jetë i lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i sistemit (DCS/SCADA të HEC Vau i Dejës).

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentim:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me specifikimet teknike për objektin e kërkuar. Objekti i kësaj procedure prokurimi përfshin ndërhyrje direkte në sistemin ekzistues të kontroll-monitorimit SCADA në HEC Vau i Dejës. Këto ndërhyrje përfshijnë shtimin e funksioneve të reja të sistemit të ndërlidhura ngushtë me ndryshimet në rregullat e tregut të energjisë, si dhe diversifikimin e kapaciteteve gjeneruese në të ardhmen.

Për të realizuar këto funksione kërkohen instalime të reja software, update të licencave ekzistuese, instalime hardware dhe konfigurime që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë sistemin 250 SCALA të instaluar.

Duke qenë se ndërhyrja do të kryhet në një sistem SCADA ekzistues, çdo integrim i elementëve të rinj duhet të jetë plotësisht i përputhshëm me arkitekturën dhe licencimin e sistemit aktual. Për pasojë, është thelbësore që operatori ekonomik të ketë marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin ose me një distributor të autorizuar të këtij sistemi sepse është mënyra e vetme teknike për të garantuar që ndërhyrjet e propozuara do të jenë të vlefshme, të qëndrueshme, të certifikuara dhe nuk do të dëmtojnë integritetin e sistemit ekzistues.

Për më tepër, sistemi SCADA në HEC Vau i Dejës është klasifikuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike si një sistem kritik për infrastrukturën energjetike të vendit. Çdo ndërhyrje në këtë sistem përbën një rrezik potencial nëse nuk realizohet në përputhje të plotë me standardet e prodhuesit. Autorizimi zyrtar nga prodhuesi ose nga një distributor i certifikuar është një garanci shtesë që ndërhyrja nuk do të çënojë sigurinë kibernetike, operimin normal dhe funksionalitetin e sistemit.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar është një masë mbrojtëse teknike e nevojshme për të ruajtur funksionimin korrekt dhe të sigurt të sistemit SCADA në përputhje me interesin publik, sigurinë kombëtare dhe qëndrueshmërinë operationale të impiantit. Në mungesë të këtij autorizimi, çdo operator do të rrezikonte të kryente punime jo të mbështetura nga prodhuesi, me pasoja të rënda teknike dhe juridike për autoritetin kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të ketë të punësuar minimalisht tre (3) inxhinierë, si më poshtë:

1. Të paktën një (1) inxhinier elektronik.
2. Të paktën një (1) inxhinier elektrik.
3. Të paktën një (1) inxhinier në fushën e informatikës ose të teknologjisë së informacionit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Diploma;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Gusht 2025 – Tetor 2025.

Argumentimi:

Ky kriter përputhet me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 40, pika 5, germa c, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kërkesa për të pasur të punësuar minimalisht tre (3) inxhinierë të diplomuar në degët e inxhinierisë elektronike, elektrike dhe informatike/TIK është në përputhje të plotë me natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të kësaj kontrate. Ky kriter lidhet ngushtësisht me specifikimet teknike dhe është vendosur me qëllim që operatori ekonomik të demonstrojë se ka kapacitetin profesional dhe teknik të domosdoshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Objekti i kësaj kontrate përfshin punime dhe procese të ndërthurura në fushat e elektronikës, energjisë elektrike dhe teknologjisë së informacionit, të cilat kërkojnë ekspertizë të specializuar për secilën disiplinë. Më konkretisht:

Inxhinieri elektronik: është i domosdoshëm për garantimin e realizimit me sukses të furnizimeve dhe instalimeve të pajisjeve hardware të reja, si dhe pajisjeve kompjuterike që përbëjnë arkitekturën teknike të sistemit. Referuar specifikimeve teknike, implementimi i modulit të ri kërkon ndërhyrje të specializuar në pajisje elektronike.

Inxhinieri elektrik: nevojitet për të siguruar furnizimin dhe instalimin korrekt të pajisjeve që do të integrohen në sistemin ekzistues, veçanërisht në RACK-un aktual, duke garantuar furnizimin me energji elektrike nga një burim i sigurt dhe redundant. Ky rol është kyç për sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe pa ndërprerje të sistemit.

Inxhinier informatike/TIK: është thelbësor për instalimin, konfigurimin dhe parametrizimin e platformës software, sipas kërkesave të specifikuara në dokumentacionin teknik. Ai do të mundësojë integrimin funksional të sistemit me kërkesat operationale dhe teknike të autoritetit kontraktor.

Kjo strukturë e personelit siguron që operatori ekonomik të përmbushë në mënyrë të plotë dhe profesionale të gjitha aspektet e kontratës, duke përfshirë jo vetëm furnizimin dhe instalimin e pajisjeve, por edhe integrimin e tyre në një sistem funksional dhe të sigurt.

Në këtë mënyrë, kërkesa për personel të kualifikuar nuk është e tepërt, por përbën një garanci të nevojshme për cilësinë dhe suksesin e zbatimit të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:



ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;



ISO 27001: “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”

ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 27001: “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike” - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit, të përshtatura për nevojat e organizatës me qëllim që informacioni të mbetet i sigurt dhe të mos çenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike për objektin e procedurës së prokurimit janë hartuar për të përmbushur kërkesat e reja në lidhje me operimin me skedul 15-minutësh në sistemin elektroenergjetik Shqiptar, si dhe për implementimin e një moduli të ri që do të realizojë funksionin e balancimit të fuqisë aktive të impianteve fotovoltaike që do të ndërtohen.

Realizimi i këtyre detyrave kërkon pajisje hardware shtesë (për komunikim dhe procesim), konfigurime në sistemin SCADA, si dhe shkëmbim të dhënash me impiantin fotovoltaike nëpërmjet rrjetit të OST. Kërkesat kryesore për ndërhyrjen në sistemin SCADA të HEC Vau i Dejës lidhen me **ruajtjen e sigurisë dhe integritetit të të dhënave të sistemit ekzistues**, si p.sh. ruajtja e komunikimeve me sistemet e tjera, ruajtja e file-ve të konfigurimit të pajisjeve të tjera procesuese që janë pjesë e rrjetit të komunikimit SCADA.

Në këtë kontekst, **hartimi i specifikimeve teknike është i kushtëzuar** nga parametrat e sistemit ekzistues, kërkesat për siguri kibernetike, integrimin e pajisjeve të reja dhe konfigurimet përkatëse në sistemin SCADA ekzistues të HEC Vau i Dejës.

Duke pasur parasysh se do të instalohen funksione të reja dhe mënyra e operimit të sistemit do të ndryshojë, në specifikimet teknike është parashikuar gjithashtu edhe trajnimi i stafit teknik, për të mundësuar operimin korrekt dhe të sigurt të modulit të ri që do të instalohet.

Njësia e Prokurimit